



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2023:277295

Datë: 16.05.2024

Numri i dokumentit: 05697444

P.nr.331/23

2023:277295

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTRRI-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Ferki Xhaferi, me procesmbajtësen-praktikanten Rejhane Mani në çështjen penale kundër të pandehurve A.B, B.B DHE S.B për shkak të veprës penale “Vjedhja e pyllit ” nga neni 349 par.1 e lidhur me nenin 31 te KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorit të shtetit PP.II.nr.553/23 e dt. 11.12.2023 duke vendosur lidhur me kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, më datë 22.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorit te shtetit PP.II.nr.553/23 e dt.11.12.2023 , andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I PANDEHURI I PARË:

A.B, nga i ati S dhe e ëma S e vajzërisë Sh, i lindur më ..., në fshatin ..., komuna Vushtrri, me vendbanim në fshatin ..., komuna Vushtrri, me numër personal ..., , ka te kryer katër klasa te fillores, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

I PANDEHURI I DYTË:

B.B, nga i ati A dhe e ëma Sh , e vajzërisë S, i lindur me datë ..., ne fshatin ..., komuna e Vushtrrisë , me vendbanim ne fshatin ..., komuna Vushtrri, me numër personal ..., i martuar, ka te kryer shkollën fillore te mesme te ulet, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

I PANDEHURI I TRETË:

S.B nga i ati E dhe e ëma H, e vajzërisë S, i lindur me datë ..., ne fshatin ..., komuna e Vushtrrisë , me vendbanim ne fshatin ..., komuna Vushtrri, me numër personal ..., i martuar, ka te kryer

shkollën fillore, i martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, mbrohet ne liri.

JANË FAJTORË

SEPSE: me datë 24.01.2023, rreth orës 22:20, ne pyllin publik, ne vendin e quajtur "...", fshati ..., Komuna Vushtrri, pandehurit ne bashkëkryerje me qellim te vjedhjes se trungjeve ne pyllin publik, kane prere me sharre motorike njëmbëdhjetë (11) copë trungje druri te llojit ahu, me diametër 20 – 28 cm, lartësi 14 m, me vëllim te përgjithshëm prej 3.30 m³, te cilat i kishin ngarkuar dhe kane qene duke i bartur me traktor te markës "Ferguson", me c' rast te dëmtuarës Agjencisë Pyjore te Kosovës, i kane shkaktuar dem material ne vlere totale prej 504.90 Euro.

-Me këtë ne bashkëkryerje kane kryer veprën penale: "Vjedhja e pyllit" nga neni 349 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 38, 43, 69, 70 dhe nenit 349 par.1 të KPRK-ës, si dhe bazuar ne nenet 365, 450, 493, 495 të KPP-së të pandehurve iu shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të pandehurit të parë A.B i vërteton dënim me gjobë në shumën prej 100€ (njëqind euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti.

Të pandehurit të dytë B.B i vërteton dënim me gjobë në shumën prej 100€ (njëqind euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti.

Të pandehurit të tretë S.B i vërteton dënim me gjobë në shumën prej 100€ (njëqind euro), i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti.

DETYROHEN të pandehurit që të paguajnë në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç shumën prej nga 20€ (njëzet euro), si dhe në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumën prej nga 20€ (njëzet euro). Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Pala e dëmtuar Agjencia Pyjore e Kosovës, për realizimin e kërkesës pasurore- juridike udhëzohet ne kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr553/23 e dt. 11.12.2023, kundër të pandehurve A.B, B.B dhe S.B, për shkak të veprës penale " Vjedhja e pyllit " nga neni 349 par.1 e lidhur me nenin 31 te KPRK-së Gjykatës i është kërkuar që kundër të pandehurve të

jep Urdhërin Ndëshkimor me arsyetimin e besueshëm nga kallëzimi penal dhe provat e bashkangjitura lidhur me bazueshmërinë e aktakuzës së prokurorisë se shtetit në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale “Vjedhja e pyllit” nga neni 349 par.1, të KPRK, me të cilën akuzohen të pandehurit, ligjvënësi ka parashikuar dënimin me gjobë ose burgim deri në një (1) vit, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes e konform nenit 493 dhe 494 të KPPK-së, Gjyqtari i vetëm gjykues gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 të KPPK-së dhe konform dispozitave nga neni 495 par.1 të KPPK-së ashtu që mori vendim që ta pranoj kërkesën për dhënien e urdhërit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: Fletëparaqitje për dëmtimin e pyllit e datës 24.01.2023; raport për demin e shkaktuar me numër 15/23 e datës 03.04.2023, procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.B i datës 18.08.2023; procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin B.B i datës 18.08.2023; procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin S.B i datës 18.08.2023; raport i oficerit i datës 18.08.2023, janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se në veprimet e të akuzuarve ekzistojnë elemente të veprës penale “Vjedhja e pyllit” nga neni 349 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, për këtë edhe i shqipton urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mori parasysh rrethanat lehtësuese si: si rrethana rënduese gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale, meqë në këtë rast vepra është kryer me dashje nga ana e të pandehurve, mënyrën e kryerjes së veprës penale dhe faktin se veprat penale të këtij lloji janë në rritje, ndërsa rrethana të tjera rënduese gjykata nuk gjeti.

Gjykata çmon se dënimi me kusht i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, dhe është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurve dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Së këndejmi me praninë e të gjitha këtyre rrethanave nuk ka pasur vend që të pandehurve t’u shqiptohet dënim më i butë ose më i rëndë.

Andaj gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit si në nenin 38 të KPRK-së, që të parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tyre, që në të ardhmen të pandehurit të kenë kujdes të shtuar që të mos bien në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tyre, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e mori në kuptim të nenit 450 par.2 nën paragrafi 2.6 lidhur me par. 1 të KPPK-së, vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e mori në bazë të nenit 39 par.3 pika 3.1 të Ligjit nr. 05/L-36 për Kompensimin e

Viktimave të Krimet, ndërsa vendimin mbi kërkesën pasurore juridike gjykata e morri ne baze te nenit 462 par.2 te KPP-se.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE-DEGA NE VUSHTERRI

Departamenti i përgjithshëm-Divizioni penal

P.nr.331/23, të datës 22.03.2024

Procesmbajtësja-praktikantja
Rejhane Mani

Gjyqtari i vetëm gjykues
Ferki Xhaferi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet kundërshtimi në afat prej 8 ditëve nga dita e marrjes me shkrim. Kundërshtimi i drejtohet kësaj gjykate me shkrim apo me gojë në procesverbal të gjykatës.